Monitorim i resurseve ujore: Si të përcaktohet gjendja reale?

PROF. D-R BILJANA PULESKA JANUSHEVSKA,
M-R DEJAN ANDONOV



Rezyme

Monitorimi egzistues i kualitetit dhe kuantitetit të ujërave në Maqedoni është i papërshtatshëm për të dhënë fotografi reale për gjendjen e resurseve ujore. Arsyet për këtë situatë janë mosegzistimi i programeve për monitorim dhe paraqitjes kartografike sipas kërkesave të Ligjit për ujëra, resurse të pamjaftueshme financiare dhe të kuadrove, gjendja e keqe e stacioneve matëse shtetërore dhe mospërmbushja e detyrimeve për monitorim të mbrendshëm. Për shkak të kësaj situate, nuk mund të kemi përcjellje dhe evaluim sistematik dhe të kontinuar, dhe organet nuk mund ti sigurojnë të dhënat e duhura për menaxhimin me ujërat. Në kontekst të ujërave sipërfaqësore, kjo do të thotë mungesë e të dhënave për klasifikim të statutit të ujërave sipërfaqësore, për ndryshimet që ndodhin si aktivitet antropogjen, sidomos nga lëshimet e materieve ndotëse. Në kontekst të ujërave nëntokësore, kjo do të thotë mungesë e të dhënave për statutin kuantitativ të trupave ujore nëntokësore, për statutin kimik të tyre, për prezencën e koncentrimit të materieve ndotëse dhe vlerësim të ndryshimeve si rezultat i kushteve natyrore dhe aktiviteteve antropogjene. Mungesa e të dhënave reale për statutin e trupave ujore do të thotë se vihet në pyetje arsyeshmëria, qëndrueshmëria, racionaliteti dhe efikasiteti i politikave dhe masave menaxhuese për shfrytëzim dhe mbrojtje të ujërave.

Rekomandime për MMJPH

- Të sjellen akte nënligjore lidhur me krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit për monitorim të ujërave;
- Të përmirsohet sistemi për mbledhje dhe transfer i të dhënave dhe informatave të lidhura me monitorimin dhe të vendoset sistem për menaxhim me të dhënat të fituara nga monitorimi në drejtim të krijimit të politikave të qëndrueshme për menaxhim ne ujërat;
- Të mundësohet qasje deri te informatat nga sistemi deri te organet inspektuese për shkak të implementimit të detyrimeve lidhur me monitorimin e ujërave;
- Të mundësohet qasje e publikut deri te të dhënat nga sistemi në pajtim me rekomandimet për qajse të lirë në informata të karakterit publik, pa kërkesa dhe veprime të posaçme.

Rekomandime për subjekte fizike dhe ligjore

- Të sigurojnë licenca ujore me detyrime konkrete për monitorim;
- Të sigurojnë matje të sasisë dhe analizë të kualitetit të ujërave që i zënë/përdorin dhe lëshojnë në natyrë;
- Të dorëzojnë të dhëna nga monitorimi deri te MMJPH.

Rekomandime për qeverinë e RMV

- Të veçohet buxhet adekuat dhe i regullt për sanacion dhe mirëmbajtje të rrjetit hidrologjik për monitorim dhe krijim dhe mirëmbajtje të rrjetit shtetëror për monitorim të ujërave, që të mundësohet përcjellje sistematike e statutit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe zonave të mbrojtura;
- Të definohet statuti i DPHM dhe raporti me MMJPH në sistemin për monitorim të gjendjes të ujërave me vendim ligjor (qartë të përcaktohet kush është i obliguar për krijimin e rrjetit, operativitetin e tij, mirëmbajtje dhe zhvillim; kush e pregadit dhe e sjell programin për monitorim; kush kryen monitorim faktik të ujërave, si dhe të përcaktohet buxhet i regullt dhe adekuat në lidhje me këto detyrime);
- Të përshkruhen kushtet, mënyra, dhe veprimi për vendosje dhe punë i të gjithë rrjeteve për monitorim të gjendjes të trupave ujore dhe të sjellen programe për monitorim për çdo rajon të rjedhës lumore.

Ligji për ujëra qartë thotë se duhet të ketë përcjellje sistematike dhe të kontinuar të statutit të ujërave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, si dhe të zonave të mbrojtura. Për atë qëllim, parashihet sjellje dhe zbatim i programeve për monitorim (mbikqyrës, operativ dhe hulumtues) me të cilat do të mundësohet shqyrtim koherent dhe gjithëpërfshirës i statutit të ujërave në çdo rajon të rrjedhave lumore. Për aktivitetet të monitorimit kërkohen dhe paraqitje kartografike të rrjeteve për monitorim, të gjendjes të ujit dhe të trupave të ujërave nëntokësore, të cilat janë subjekt të një trendi të rëndësishëm në rritje të koncentrimit të ndotësve. Për bartësit e licencave, ligji parasheh dhe detyrim për monitorim të mbrendshëm të përdorimeve dhe lëshimeve. Deri tani, programe për monitorim dhe paraqitje sipas Ligjit për ujëra nuk janë të sjellura, dhe matjet, parametrat, metodat dhe dinamika nuk janë në pajtim me kërkesat, ashtu që nuk mund të bëhet fjalë për përcjellje sistematike dhe të kontinuar, evaluim dhe të dhëna për ujërat dhe zonat e mbrojtura.

Nuk ka informata të mjaftueshme dhe të sigurta për statutin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Të dhënat nga monitorimi që janë në dispozicion nëpërmjet rrjetit shtetëror hidrologjik mundësojnë vetëm kontrollë të pjesërishme të statutit të **ujërave sipërfaqësore** në shtet. Nuk ka të dhëna të sakta për kualitetin dhe kuantitetin e **ujërave nëntokësore**, gjë që rrjetin shtetëror hidrologjik e bën jooperativ për monitorim në raport me qëllimet e Ligjit për ujëra. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për interakcione specifike me ekosistemet. Për vlerësim të ndikimeve të mundshme negative nga aktivitetet antropogjene (hedhurina, ujëra të zeza, aktivitete bujqësore- nitrate, pesticide dhe industria), posaqërisht në rajone të ndjeshme hidrogjeologjike, nuk ka të dhëna të mjaftueshme. Rrjeti për monitorim hidrologjik i Drejtorisë për punë hidrometeorologjike (DPHM) përbëhet nga 110 stacione për ujëra sipërfaqësore dhe 115 stacione për ujëra nëntokësore, nga të cilat,në përmbyllje me vitin 2018, në funkcion janë vetëm 65 stacione për ujëra sipërfaqësore dhe 38 për ato nëntokësore. E rëndësishme është dhe informata se rrjeti i DHPM, prej ku dhe merren dhe shfrytëzohen të dhënat për monitorim të ujërave, është etabluar për marrjen e të dhënave për nevoja hidrometeorologjike dhe se ato në sasi të caktuar mund të përputhen me monitorimin të paraparë me Ligjin për ujëra, sidoqoftë rrjeti nuk është e krijuar ti jep të gjitha të dhënat relevante për menaxhimin. Edhe përkrah tentimit të zbatohet monitorim në pajtim me Ligjin për ujëra dhe me instrumentet relevante të bashkësisë Europjane(edhe pse në Ligjin për ujëra nuk ka ashtu lloj autorizimi direkt dhe ajo është obligim i Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor), DHPM ballafaqohet me vështirësi në përcjelljen të disa parametrave për kualitet, që vjen si rezultat i mungesës të pajisjeve dhe laboratorit adekuat dhe bashkëkohor. Kjo do të thotë se analizohen vetëm disa parametra të caktuara: metale të rënda(Cd, Pb и Ni) dhe vetëm tre parametra biologjik (fauna pakurizore, fitobentos dhe fitoplankton), dhe tjerat (makrofite dhe peshq) ende nuk ju nënshtrohen monitorimit të regullt. Monitorimi i DHPM fokusohet në lumej dhe alumulacione, dhe të dhënat për përcjellje të liqeneve nuk janë të inkuadruara.

Më tej, monitorim dhe evaluim i kontinuar bëhet edhe për **kualitetin dhe sigurinë e ujit për konsum** dhe të sistemeve publike për furnizim me ujë. Në pajtim me programet për shëndet publik, dhjetë qendrat për shëndet publik, nëpërmjet kontrolleve sanitaro-higjienike, marje të mostrave dhe analizave laboratorike të rëndësishme për shëndetin e popullatës, e analizojnë sigurinë e ujit të pijshëm dhe gjendjen sanitaro-higjienike të furnizimit me ujë dhe zbatojnë



dhe propozojnë masa për siguri të ujit të pijshëm. Raporte vjetore për përcjellje të kualitetit të ujit për pije përgadit Instituti për shëndet publik. Monitorim kontrollues të sistemeve komunale për furnizim publik me ujë kryhet në mënyrë periodike nga ana e Institutit.

Sipas Ligjit për ujëra, ndërrmarjet komunale publike (NKP) janë të detyruara të kryejnë monitorim të sasive të zëna dhe të shterura **të ujit për furnizim publik me ujë** dhe të instalojnë dhe të mirëmbajnë gjendje të regullt, instrumente për analizë të kualitetit dhe për matje të ujit, si dhe me dinamikë të caktuar ti dorëzojnë të dhënat deri te organet kompetente. Të gjitha ndërrmarjet publike nuk kanë të instaluar instrumente për matje të sasive të zëna dhe të përdorura, si dhe nuk dorëzojnë regullisht të dhëna për sasinë e ujit që e përdorin.

Në lidhje me monitorimin e ujërave të zeza, operatorët të instalacioneve janë të detyruar të kryejnë monitorim të sasisë dhe parametrave në **ujërat e zeza** që i lëshojnë. Edhe ndërrmarjet komunale publike që lëshojnë ujëra të zeza janë të detyruara të instalojnë instrumente për matje të sasive të lëshuara dhe instrumente për analizë të kualitetit të tyre. Janë të detyruar të dhënat ti dorëzojnë deri te MMJPH. Detyrimet për operatorët dhe për ndërrmarjet komunale publike janë të përcaktuara dhe të përmbajtura edhe në licencat e dhëna për lëshimin e ujit. Vetëm ndërrmarjet komunale publike me stacione funksionale për pastrim, si dhe NKP pa stacione funksionale(si për shembull në Shkup dhe në Shtip), kanë instrumente për matje të sasisë dhe kualitetit të ujërave të lëshuara, por shkrimet dhe të dhënat nga matjet e kryera shumë shpesh nuk dorëzohen deri te MMJPH. Komunat tjera/NNP nuk kanë instrumente të vendosura dhe nuk bëjnë matje të sasisë dhe kualitetit të ujërave të papastruara që direkt i lëshojnë në recipientin. Problem shtesë e kësaj gjendje paraqet dhe problemi i monitorimit i ujërave të zeza për instalacionet dhe ndërrmarjet komunale publike që lëshojnë pa licencë.

Nuk është përcaktuar as monitorim për sasinë dhe kualitetin e ujërave që përdoren/lëshohen dhe për ujitje, dhe tjera shërbime.

Cilat janë arsyet që sistemi nuk funkcionon?

Mungesa e përcjelljes sistemike dhe të kontinuar është për shkak të disa arsyeve kryesore.

E para është se aktet nënligjore që janë relevante për implementimin e detyrimeve ligjore të lidhura me sistemin e monitorimit nuk janë të miratuara. Në numër më të madh ato janë në kompetencë të MMJPH, veçmas ose në bashkëpunim me ministri tjera.

Arsye e dytë bazike i referohet kufizimit joadekuat të kompetencave institucionale për monitorim të ujërave. Roli i DPHM nuk është i përcaktuar në mënyrë eksplicite me Ligjin për ujëra dhe e menaxhon rrjetin shtetëror hidrologjik i cila është krijuar në pajtim me regullat hidrologjike. Ky është ndryshe nga rrjeti shtetëror për monitorim të ujërave, i cili duhet të përcaktohet sipas Ligjit për ujëra dhe të jetë i dizajnuar në varshmëri nga presionet , si medium i mjedisit jetësor. Edhe pse përcjellja e dy rrjeteve- hidrologjike dhe ekologjike- është e ndarë, në disa raste lokacionet për vendet matëse dhe parametrat mund të përputhen. DPHM ka kapacitet, dituri dhe pajisje të kryejnë monitorim të ujërave, por roli sështë i definuar me ligj që të mundëson program efektiv për monitorim të ujërave sipas Ligjit për ujëra .

Më tej, kufizimet në buxhet ndikojnë në operativitetin i rrjetit monitorues aktual, si dhe në shpenzimet investuese për krijimin e stacioneve të reja matëse dhe rrjet të ri shtetëror për monitorim të ujërave.

Numri i vogël i stacioneve për pastrim për trajtim të ujërave të zeza dhe joinstalimi i instrumenteve për matje të sasisë dhe për analizë të kualitetit të ujërave të lëshuara, si dhe mosdorëzimi i të dhënave nga matjet janë probleme plotësuese për shkak të cilave nuk ka fotografi të përgjithshme për gjendjen e trupave ujore.

Buxheti indikativ për pregaditje të programit për monitorim të trupave ujore vlerësohet të jetë 109.867 euro. Kjo nuk i llogarit dhe shpenzimet për monitorim operativ, për të cilin do të ketë implikacione finansiare plotësuese për laboratore dhe pajisje që duhet të llogariten varësisht nga nevojat të përcaktuara me vetë programet.

Burime të konsultuara

- Puleska B., Popovski (2020). Probleme në menaxhimin me resurset ujore: Si ta shfrytëzojmë dhe ta mbrojmë ujin. Instituti për studime komunikative, Shkup.
- United Nations Publications (2019). Environmental Performance Report North Macedonia. ECE/CEP186, third review, Geneva.
- Enti shtetëror për revizion (2019). Raport final për revizion të kryer të suksesshmërisë „Efektivitet nga politikat, masat dhe aktivitetet gjatë dhënies të licencës ujore “. ESHR, Shkup.



Më tepër në temën të kësaj rezyme është shpjeguar në dokumentin për politikë publike

„Problemet Në Menaxhimin Me Resurset Ujore: Si Ta Shfrytëzojmë Dhe Ta Mbrojmë Ujin“.

Институт за комуникациски студии
02 30 90 004 info@iks.edu.mk www.iks.edu.mk

British Embassy Skopje
UKaid from the British people

Ky produkt është pregaditur në suaza të proektit “Bashko pikat: Politika të përmirsuara nëpërmjet pjesëmarjes qytetare“, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë të Bashkuar, me përkrahje të ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet të përmendura në këtë përmbajtje nuk i reflektojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë britaneze.